

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi:	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia
Titulli i lëndës:	Ndërmarrësia
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II
Semestri:	IV
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	USHAF
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Ndërmarrësia është lëndë e cila u mundëson studentëve të njihen me figurën e ndërmarrësit, karakteristikat e tij, mënyrat se si bëhet një hulumtim i mirëfillit i tregut, studimi i fizibilitetit, mënyrat e testimit të idesë ndërmarrëse, njohja e blerësit, krijimi dhe përpilimi i planit të biznesit, menaxhimi i ndërmarrjes, etj. Teoria e ndërmarrësisë: një metodë, një aparat i mendjes, një teknikë e të menduarit, që e ndihmon zotëruesin e saj të nxjerrë dhe të marrë vendime të drejta, në kohë të duhur. Ndërmarrësia trajtohet si pjesë të aktiviteteve afariste dhe të detyrave udhëheqëse, pjesë të menaxhmentit ndërmarrës.
Qëllimet e lëndës	Me anë të kësaj lënde synohet që studentëve t'u ofrohen njohuritë themelore mbi çështjet teorike – shkencore në fushën e ndërmarrësisë. Thënë shkurt, qëllimet themelore të cilat pretendohen të arrihen janë: të kuptuarit më të lehtë, të ndodhive dhe trendeve në biznesin e vogël privat në ekonominë kosovare, dhe rolit krucial që luajnë ndërmarrësit në ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme; procesi i ndërmarrësisë, nga studentët dhe të tjerët, nga entuziastët e inovatorët, të përdoret si metodë e pasurimit të tyre, përmes zënjes së dijes, aftësive, dhe shkathtësive për të pasur sukses.
Rezultatet e pritura të mësim-nxënies	Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të: 1. Njohuritë bazë të ndërmarrjes, (ECTS: 1), 2. Njohuri për mënyrën e themelimit të ndërmarrjes, (ECTS:1), 3. Njohuri për zbatimin e strategjisë financiare të ndërmarrjes, (ECTS: 1), 4. Aftësi për të zbatuar praktikisht njohuritë për planin e punës në ndërmarrje, funksionalizimi i aftësive të fituara duke qenë pjesë e ekipit për të udhëhequr ndërmarrjen, si dhe të zbatojë njohuritë për efikasitetin e punës në ndërmarrje, (ECTS: 1), 5. Kompetent për të qenë pjesë e ekipit për të realizuar hartimin e një plani bazë për një ndërmarrje, për të kryer analiza për të identifikuar metodën më të mirë të

	funksionimit të ndërmarrjes, si dhe do të jetë kompetent për planin e investimit për të identifikuar koston dhe fitimin në të ardhmen, (ECTS: 1),		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë/Vizitë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	5	5
Përgatitja për detyra projekte			
Projekt kursi – Test (planifikim + zbatim)	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			40
Përgatitja përfundimtare në provim	1	10	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet etj	1	5	5
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies	Ligjërata do te organizohet duke pas studentin ne qendër, mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjëratave, ushtrimeve, shembujve praktikë, interpretimeve individuale e grupe, plane biznesi, punim të seminareve, vlerësimeve periodike, etj. Të gjitha këto do të realizohet në aspektin teorik dhe praktik duke i prezantuar materialet në formën audio-vizuale përmes teknologjisë elektronike me programet e Windows Office. Në aspektin teorik do të ofrohen njohuri të përgjithshme shkencore, bazuar në literaturën bashkëkohore. Pjesa praktike kryesisht do të realizohet përmes shembujve konkret nga literatura dhe punimeve studentore, do te dëgjohet opinioni i studenteve për literaturën qe do te përdoret, për mënyrën e organizimit te ligjëratës e cila do te jete interaktive lidhur me temat e ligjëruara, orientimi ne shtjellimin e materialit do te diskutohen ne grup - vizite praktike, prezantimi i studenteve për Raste studimi, Punime seminari apo Hulumtim.		
Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë	Metoda e vlerësimit – mbështetet ne tri aktivitete – ne baze të të cilave do te ndërtohet nota përfundimtare: ➤ Aktivitet dhe Rasti i studimit.....max 10 pikë (%), ➤ Hartimi / prezantimi i Planit te Biznesit.....max 20 pikë (%), ➤ Provimi final (ose nga dy teste).....max 70 pikë (%), Kriteret e kalueshmërisë - ndërlidhur me aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit: 1. Aktiviteti në mësim dhe Rasti i studimit – vlerësohet me 10 pikë (%) nga 100 pikët (%)e mundshme: • Aktiviteti në mësim (5 pikë (%)) - nënkupton që studenti te jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë,		

studentë-studentë, duke hapur tema te reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjëratave.

- Rasti i studimit (**5 pikë (%)**) - nënkupton që studenti të realizon një rastë studimi ndërlidhur me ndërmarrësin dhe ta prezantoj te njëjtin para studenteve.

Qëllimi: Nxitja e mendimit kritik dhe zgjidhja kreative e situatave reale ndërlidhur me problemet e parashtruara - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës.

2. Hartimi dhe prezantimi i Planit të Biznesit - vlerësohet me 20 pikë nga 100 pikët (%) e mundshme,

Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studenteve – jo më shumë se 4 studentë) duhet të përgatit një Plan Biznesor (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim i planit duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Prezantimi do të zgjasë më së shumti 15 minuta. Plani biznesor prezantohet para grupit dhe vlerësohet në bazë të cilësisë së përmbajtjes, analizës, kreativitetit dhe aftësisë për ta prezantuar qartë.

Kriteret e vlerësimit të planit biznesor	
Komponenti	Pikët (%)
Struktura e planit biznesor	4
Përmbajtja/shtjellimi i planit	9
Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi	7
Gjithsej:	20

Qëllimi: zhvillimi i aftësive analitike dhe shkencore, përmes trajtimit të një plani reale biznesor - në mënyrë të pavarur dhe akademike - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës.

3. Testi i provimit final, vlerësohet me 70 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme,

Brenda semestrit parashihet të mbahen dy Teste (2 x 35 pikë (%)) për studentët e angazhuar aktiv me pjesëmarrje në ligjëratat, testi i parë në javën e 7 ose të 8 dhe testi i dytë në fund të ligjëratave, studenti e kalon testin nëse ka min 18 pikë (%), pasi që studenti vlerësohet se ka kaluar testin e parë, atëherë studenti mund t'i nënshtrohet testit të dytë studenti ka të drejtë të nënshtrohet drejtpërdrejt provimit final - me gojë ose me shkrim. Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuara nga senati i Universitetit.

Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban:

- ♦ pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri-kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës.....**30 pikë (%)**,
- ♦ pyetje subjektive të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studenti duhet të jete në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjësuar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit

	dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit...40 pikë (%) Qëllimi i testit: është që të vlerësohet njohuria, aftësia, shkathhtësia dhe kompetencat e studentit, ndërlidhur me rezultatet e mësim-nxënies të parapara në modulën e lëndës dhe për t'i zbatuar ato në situata praktike. Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit, Notat në UShAF: <table><tr><th>Nota</th><th>ECTS/Nota</th><th>Përqindja (%)</th><th>Përkufizimi</th></tr><tr><td>10</td><td>A</td><td>90 - 100</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>9</td><td>B</td><td>80 - 89</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>8</td><td>C</td><td>70 - 79</td><td>Shumë mirë</td></tr><tr><td>7</td><td>D</td><td>60 - 69</td><td>Mirë</td></tr><tr><td>6</td><td>E</td><td>50 - 59</td><td>Mjaftueshëm</td></tr><tr><td>5</td><td>FX/F</td><td>0 - 49</td><td>Pamjaftueshëm</td></tr></table>	Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi	10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm	9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm	8	C	70 - 79	Shumë mirë	7	D	60 - 69	Mirë	6	E	50 - 59	Mjaftueshëm	5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm
Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi																										
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm																										
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm																										
8	C	70 - 79	Shumë mirë																										
7	D	60 - 69	Mirë																										
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm																										
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm																										
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi i tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve “on-line” për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.																												
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	80% - Teori, 20% - Ushtrime/detyra praktike, Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave të parapara në modulën e lëndës dhe realizimit të ushtrimeve praktike (vizita praktike, ushtrime me studentë, kuize studentore në klase, etj). Nga gjithsej 125 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 80% me fokus në teori dhe 20% në ushtrime/detyra praktike. • 100 orë janë të dedikuara për ligjërata teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologjive dhe standardeve të parapara në modulën e lëndës. • 25 orë janë të fokusuar në ushtrime/detyra praktike, analiza rastesh konkrete, punë në grup dhe zhvillim projektsh simulimi. Ndarja e 6 ECTS sipas raportit 80%-20% ❖ 4 ECTS - i dedikohen pjesës teorike, ❖ 1 ECTS - i dedikohen pjesës ushtrime/detyra praktike, Kjo ndarje reflekton balancën ndërmjet përvetësimit të koncepteve bazë dhe zbatimit të tyre përmes aktiviteteve praktike.																												
Literatura																													
Literatura bazë	1. Prof. Dr. Anastas Angjeli, Prof. As. Dr. Ermelinda Kordha, Prof. As. Dr. Alma Spaho “Ndërmarrësi” Tiranë 2020 2. Emeric Solymossy & Safet Merovci, “Ndërmarrësia”, Prishtinë, 2008. 3. Charles Bamford, Garry Bruton, 2021, Entrepreneurship: The Art, Science, and Process for Success, Fourth Edition, MC Graw Hill, Texas Christian University,																												
Literatura shtesë	1. Rob Yeung, “The rules of Entrepreneurship”, 2007 2. “Entrepreneur’s Toolkit”, Harvard Business Essentials, 2005.																												

<i>Informacion shitesë – Punimi Shkencor nga profesori i lëndës:</i>	* Punimi Shkencor - nga autorët: Arben Tërstena, Ismail Mehmeti & Sokol Krasniqi: Titulli: “Analiza e perceptimeve të pronarëve dhe menaxherëve mbi faktorët që ndikojnë në efektivitetin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme: Evidenca nga Kosova” Butuar në: International Journal of Applied Economics, Finance and Accounting Vol. 17, No. 1, pp. 67-75, ISSN2577-767X Jun 2023 http://onlineacademicpress.com/index.php/IJAEFA/article/view/1036/765 https://www.scopus.com/authid/detail.uri?authorId=57961121300
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Prezantimi – njoftimi i studenteve me syllabusin e lëndës, Diskutim me studentet për lëndën, për literaturën, për materialin shitesë, për aktivitetet e parapara gjatë ligjëratave, marrja e informatave kthyes nga studentët, etj. Hyrje - Përmbajtja e leksioneve “Në këtë ligjëratë studentët do të njoftohen me qëllimet, përmbajtjen dhe strukturën e lëndës ‘Ndërmarrësia’. Do të prezantohen temat kryesore të ligjëratave, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit, si dhe aktivitetet praktike dhe projektet seminarike që do të zhvillohen gjatë semestrit.”. Rezultati i pritur nr. 1.
Java e dytë	Çka është ndërmarrësia?, “Në këtë ligjëratë studentët do të njoftohen me konceptin e ndërmarrësisë, definicionet kryesore mbi ndërmarrësin dhe rolin e saj si teknologji sociale. Do të diskutohet se kush konsiderohet ndërmarrës dhe rëndësia e këtij nocioni për zhvillimin ekonomik e shoqëror.” Rezultati i pritur nr. 1.
Java e tretë	Kush është ndërmarrës? Në këtë ligjëratë studentët do të njoftohen me atributet individuale të ndërmarrësve, sjelljet ndërmarrëse dhe motivet për fillimin e biznesit. Do të trajtohen dallimet mes ndërmarrësve dhe menaxherëve, duke theksuar rëndësinë e rolit të ndërmarrësve në krijimin e vlerës dhe inovacionit.”, Rezultati i pritur nr. 1 dhe 2.
Java e katërt	Analiza dhe hulumtimet e tregut “Në këtë ligjëratë studentët do të njoftohen me rëndësinë e analizës dhe hulumtimeve të tregut për ndërmarrësinë. Do të trajtohet procesi i identifikimit të oportuniteteve dhe mënyrat se si ato shërbejnë për zhvillimin e ideve të reja të biznesit dhe krijimin e avantazhit konkurrues.”. Rezultati i pritur nr. 2.
Java e pestë	Analiza dhe hulumtimet e tregut

	“Në këtë ligjëratë studentët do të njoftohen me rolin e kreativitetit dhe inovacionit në procesin e analizës së tregut. Do të diskutohet se si aftësia për të zgjedhur probleme dhe për të ofruar zgjidhje kreative kontribuon në zhvillimin e ideve të reja dhe përparësinë konkurruese të ndërmarrjes.”. Rezultati i prituri nr. 4.
Java e gjashtë	Studimi i Fizibilitetit – Frytshmerisë “Në këtë ligjëratë studentët do të njoftohen me procesin e studimit të fizibilitetit dhe vlerësimin e frytshmerisë së një ideje biznesi. Do të trajtohet gjithashtu vetë-analiza e aftësive dhe resurseve për të përcaktuar potencialin e suksesit të ndërmarrjes.”. Rezultati i prituri nr. 4.
Java e shtatë	Studimi i Fizibilitetit – Frytshmërisë, Tema nga Punimi Shkencor: Analiza e perceptimeve të pronarëve dhe menaxherëve mbi faktorët që ndikojnë në efektivitetin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, “Në këtë ligjëratë studentët do të njoftohen me studimin e fizibilitetit dhe procesin e vlerësimit të frytshmërisë së një ideje biznesi. Do të trajtohet rëndësia e vetë-analizës në përcaktimin e aftësive, resurseve dhe kapaciteteve që ndikojnë në suksesin e ndërmarrjes. Do të diskutohen faktorët që ndikojnë në efektivitetin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme”. Rezultati i prituri nr. 2 dhe 3.
Java e tetë	Vlerësimi i dijes “Në këtë ligjëratë studentët do të angazhohen në kolokfiumin e parë për të vlerësuar njohuritë e fituara deri më tani mbi konceptet e ndërmarrësisë, analizën e tregut, kreativitetin, inovacionin dhe studimin e fizibilitetit. Aktiviteti do të forcojë kuptimin dhe përgatitjen për detyrat praktike dhe projektet seminarike.”. Rezultati i prituri nr. 5. Parashihet të organizohet Testi i parë,
Java e nëntë	Testimi i idesë ndërmarrëse “Në këtë ligjëratë studentët do të njoftohen me procesin e testimit të ideve ndërmarrëse. Do të trajtohet mënyra për të vlerësuar realizueshmërinë dhe potencialin e një ideje biznesi në treg, duke identifikuar rreziqet dhe mundësitë për suksesin e ndërmarrjes.”. Rezultati i prituri nr. 2.
Java e dhjetë	Blerësit – Blerësi perspektiv, “Në këtë ligjëratë studentët do të njoftohen me konceptin e blerësit dhe identifikimin e blerësit perspektiv. Do të diskutohet rëndësia e njohjes së nevojave dhe preferencave të konsumatorëve për zhvillimin e strategjive efektive të marketingut dhe suksesin e një ndërmarrjeje.”. Rezultati i prituri nr. 2.
Java e njëmbëdhjetë	Plani i biznesit “Në këtë ligjëratë studentët do të njoftohen me strukturën dhe rëndësinë e planit të biznesit. Do të trajtohen analiza e industrisë dhe ambientit të biznesit, plani i marketingut, plani financiar, plani i prodhimit, si dhe format organizative dhe plani operativ për një menaxhim efektiv të ndërmarrjes.”.

	Rezultati i pritur nr. 2.
Java e dymbëdhjetë	Përgatitja dhe Menaxhimi i ndërmarrjes “Në këtë ligjëratë studentët do të njoftohen me përgatitjen dhe menaxhimin e ndërmarrjes duke filluar me konceptin ‘Nisja me këmbë të mbarë’. Do të trajtohen çështjet organizative, stilet e menaxhmentit, menaxhimi i resurseve njerëzore, inventarit, financave dhe kredive për një funksionim efikas të biznesit.”. Rezultati i pritur nr. 3,
Java e trembëdhjetë	Inteligjenca Artificiale dhe Biznesi Ndërkombëtar “Në këtë ligjëratë studentët do të njoftohen me mundësitë e biznesit ndërkombëtar dhe rolin e Inteligjencës Artificiale në zhvillimin e tij. Do të trajtohen përdorimi i internetit, tregtia elektronike, krijimi i web-faqes, marketingu digjital, si dhe adaptimi dhe zgjerimi i menaxhmentit të bazuar në AI.”. Rezultati i pritur nr. 3.
Java e katërbëdhjetë	Prezantimi i ideve në formatin e planit të biznesit nga studentet “Në këtë ligjëratë studentët do të prezantojnë idetë e tyre në formatin e planit të biznesit. Do të praktikojnë strukturimin e planeve të marketingut, financave, prodhimit dhe organizimit, duke marrë vlerësime dhe komente për përmirësimin e ideve dhe aftësive të tyre ndërmarrëse.”. Rezultati i pritur nr. 4 dhe 5,
Java e pesëmbëdhjetë	Vlerësimi i dijes “Në këtë ligjëratë studentët do të angazhohen në kolokfiumin e dytë për të vlerësuar njohuritë e fituara mbi përgatitjen dhe menaxhimin e ndërmarrjes, biznesin ndërkombëtar, përdorimin e AI dhe zhvillimin e planeve të biznesit. Aktiviteti do të forcojë kuptimin dhe përgatitjen për detyrat praktike dhe projektet finale.”. Rezultati i pritur nr. 5, Parashihet te organizohet Testi i dytë ,
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte nda j kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësimmshënësi ka të drejtë t'i kërkoj studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	